ATRA E RINIS

**Revistë për Fëmijë**

Tiranë, me 17 Shkurt 1939

ΠΑΝΕΠΙΣΤΗΜΙΟ ΙΩΑΝΝΙΝΩΝ
ΑΡΧΕΙΟ ΕΥΛΟΓΙΟΥ ΚΟΥΡΙΛΑ
αρ.: 1 II 5.1

Fort i dashur dhe i nderuar Ungj'i im,

Ime-shoqe u-kthye këtu shëndosh' e mirë dhe fort e kënaqur nga pritjet t'uaja të përzemërta. Ju falënderonj nxehtësisht për ndihmën që më dhatë me këtë rast për Violetën t'onë dhe për kurajimin që më jepni për të vashduar ajo mësimet. Veçanërisht Ju falem nderit për rekomandimet që i dhatë për miqt t'uaj atje, po dhe mikut i shquar z. Naçi, të cilit lutem t'i jepni për shëndetjet e mia bashkë me falënderimet më të kthjellta. Ish nevojë për t'atilla rekomandime dhe e kisha nder mend. Po të jetë nevojë do t'Ju bezdisim edhe më von.

Shkolla është (siç kujtonja se e dinit ose që do t'ua shpiegonin Violeta dhe Krisanthi) Οἰκονομικὴ Σχολὴ Χριστιανικῆς Ἑνώσεως Ἑλληνίδων, e cila ka edhe Οἰκοτροφεῖον dhe kisha marrë informatat e duhura bashkë me programin. Është 3-vjeçare. Vetëm nuk jam i sigurtë në se do t'a gjejë vendin me një herë, se Shkolla na e kish dhënë jo të sigurtë, mbasi kaloj koha. Po sido që të jetë, mora parasysh që, fund' i fundit, të rrijë pak kohë në Janinë që të stërvitet në gjuhë gjer sa të hapet vendi. Pasi të marr përgjigjen që pres, merremi vesh përsëri me Juve, dhe rregullojmë vashdimin për më von.

Një lajm shumë gazmor ka qënë për mua ay që më jepni për vajzën tjetër, se e muarrtë përgjigjen e mirë andej ku jini kujdesur. Përsëri Ju falem nderit dhe Ju jam mirënjohtës, që kujdesi të m'a lehtësoni barrën e rëndë.

Kur të vini këtu fjalosemi më gjatë. Tërë familja ime Ju puthim Dorën me nderime. Dhe Theodhullo të fala.

Me nderime, Nipi juaj

Vasili